

“Shijoni Disneyland Paris me Kartën e Kreditit MasterCard nga Raiffeisen Bank”

Raiffeisen Bank Sh.a, zhvillon lojën promovionale “Shijoni Disneyland Paris me Kartën e Kreditit nga Raiffeisen Bank” sipas autorizimit të lëshuar nga Ministria e Financave, Autoriteti i Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit me Nr.1318/2, datë 22.08.2019.

1. Lloji i lojës promovionale

- a) Duke filluar nga data 2 Shtator 2019 deri 30 Nëntor 2019, Raiffesen Bank Sh.a do të organizojë një lojë promovionale për klientët individë që do të përdorin kartën e kreditit Installment MasterCard (Lekë dhe Euro) gjatë kësaj periudhe.
- b) Pas këtij afati, 90 ditësh kalendarike të kohëzgjatjes së promovionit, Raiffeisen Bank do të ofrojë mundësinë për të fituar një nga dy çmimet “Enjoy Disney Land with new MasterCard Credit Card from Raiffeisen Bank” për të gjithë klientët që do të përdorin kartën e re të kreditit installment përgjatë kësaj periudhe.
- c) Në lojën promovionale do të konsiderohen të vlefshme të gjitha veprimet e kryera me kartë dhe të autorizuar si të suksesshme gjatë periudhës së lojës promovionale.

2. Afati i lojës, sipas parashikimit të organizatorit

- a) Loja promovionale do të zhvillohet gjatë periudhës 2 Shtator 2019 deri 30 Nëntor 2019.
- b) Dy Çmimet e mëdha të fushatës promovionale do të jepen më datë 05 Dhjetor 2019.
- c) Ditët kalendarike janë ato ditë kur të gjithë klientët kartëmbajtës të kartës së re të kreditit installment mund të përdorin kartën e kreditit.
- d) Ditët që përbëjnë kalendarin promovional janë: fillon më 2 Shtator 2019 dhe mbaron më 30 Nëntor 2019
- e) Dita që hidhet shorteu për dy çmimet fituese është: 05 Dhjetor 2019.

3. Numri i çmimeve dhe mënyra e shpërblimit të fituesve

- a) Në fund të kohëzgjatjes së zhvillimit të lojës promovionale do të jepen 2 çmime që konsistojnë në ofrimin e paketës familjare (dy prindër + dy femijë) për të vizituar Disney Land Paris me të gjitha shpenzimet e përballuara nga MasterCard.
- b) Shorteu do të zhvillohet në datë 05 Dhjetor 2019. Njoftimi për orën dhe vendin e sakte se ku do të zhvillohet shorteu do të depozitohen pranë institucionit tuaj dhe organit tatimor 20(njëzet) ditë përpara datës së zhvillimit të shorteut, sipas VKM-së në fuqi.

4. Kosto për pjesëmarrësit

Klientët individë që do të jenë pjesë e kësaj loje promovionale nuk kanë kosto shtesë për pjesëmarrjen në këtë promovion. Ata janë të ftuar të përdorin produktin e ri të kartës së kreditit installment MasterCard sipas kushteve të përcaktuara për të pasur të drejtë të behen pjesë e lojës.

5. Kufizimet

- a) Nuk janë pjesë e lojës promovionale klientët aktual kartëmbajtës Revolving
- b) Nuk konsiderohen transaksione të vlefshme me kartë për lojën promovionale ato veprime që rezultojnë të pasuksesshme ose për të cilat ka më pas veprim të kthimit mbrapsht të vlerës (refund).
- c) Stafi i Raiffeisen Bank Sh.a, Raiffeisen Pensions Sh.a dhe Raiffeisen Leasing Sh.a. do të përjashtohet nga ky shorte. Këtij rregulli i nënshtrohen edhe kartat shtesë për këtë kategori.

6. Mekanizmi i promovionit

Konsiderohen të kualifikuar për të marrë pjesë në lojën promovionale (eligible) të gjithë klientët e Raiffeisen Bank Sh.a që kanë një kartë kreditit MasterCard Installment dhe që kryejnë veprimeve sipas këtyre specifikimeve:

- Transaksione mujore me vlerë minimum 300 Euro (për kartat në Euro) ose 40,000 Lekë (për kartat në Lekë).
 - Minimumi 5 (pesë) transaksione të suksesshme në muaj në muaj
- a) Çdo ditë të mbylljes së ciklit mujor të kartës së re të kreditit, do të krijohet një bazë të dhënash, me të gjithë klientët individë që do të përdorin kartën e kreditit installment MasterCard për limitet e përcaktuara min 300 Euro në muaj dhe minimumi 5 transaksione me kartën janë potenciale për të marrë pjesë në lojën promovionale. Kjo bazë të dhënash do të shfrytëzohet për shorteun që do të hidhet në datën 5 Dhjetor 2019. Baza e të dhënave te tre muajve Shtator, Tetor, Nëntor së bashku, do të përdoren për shortin final.
 - b) Me një përzgjedhje të rastësishme, nëpërmjet një programi kompjuterik do të dalin dy emra fitues. Secili fitues do të përfitojë paketën “MasterCard & Raiffeisen Bank takes you to Disney Land Paris”.
 - c) Në shorte do të përfshihen kartat e kreditit Installment të klientëve të Raiffeisen Bank. Në këtë mënyrë ata klientë që do të përdorin kartën e tyre çdo muaj me minimumin e kërkuar në numër dhe volum transaksionesh për të qenë konform rregullores, do të kenë më shumë mundësi për të fituar. Pra klienti kartëmbajtës do të ketë mundësi për të fituar për aq muaj sa plotëson kriteret për të qenë eligible (min 1 mundësi dhe maksimumi 3 mundësi).
 - d) Midis datave 1 dhe 4 Dhjetor 2019, do të përpunohet informacioni për të gjithë klientët kartëmbajtës që janë eligible për të fituar një nga dy çmimet e mëdha.
 - e) Elementi që përcakton fituesin është Emri, Mbiemri, NRP, Qyteti/Rrethi dhe numri i kartës së kreditit i maskuar që shpall kartëmbajtësin fitues.
 - f) Njoftimi i klientëve fitues do jetë nëpërmjet telefonatës në numrin e telefonit të depozituar në bankë nga klienti.